



**BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE**

(Pasqyra 14/Sh)

**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

GUSHT 2021

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh për muajin gusht 2021 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në të gjitha bashkitë e vendit.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit gusht 2021 zënë 65.4 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 520.85/100.000 banorë. Dihet që periudha e muajve të nxehtë të vitit mbart me vete frekuencën më të lartë të episodeve diarreike, ku në muajin gusht vihet re një tendencë në rritje e sëmundjeve diarreike. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 2.58/100.000 banorë. Rrethet Berat dhe Bulqizë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rretheve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Gjatë muajit gusht 2021 janë raportuar 9 raste (Incidenca 0.31/100.000 banorë) të konfirmuara me Salmonelozë jotifoide. NJVKSH Shkodër ka raportuar 4 raste të konfirmuara (Incidenca 3.6/100.000 banorë) me Salmonelozë jotifoide, NJVKSH Korçë 3 raste të konfirmuara (Incidenca 5.2/100.000 banorë) dhe përkatësisht, nga një rast kanë raportuar NJVKSH Tiranë dhe Berat. Bashkia Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Shigelozës për muajin gusht 2021 në nivel kombëtar 15 raste të konfirmuara, dhe përkatësisht nga një rast kanë raportuar NJVKSH Tiranë dhe Korçë.

**Tabela 1: Frekuenat dhe incidenat e sëmundjeve diarreike për muajin gusht 2021
(Incidenca raste/100.000 banorë)**

	Raste gusht 2021	Incidenca gusht 2021 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmoneloza	9	0.31
Shigelozë (Disenteri bacilare)	17	0.59
Dizenteri amebike	0	0
Toksiko-infeksione alimentare	74	2.58
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	14809	517.35
Sëmundje diarreike në total	14909	520.85

2. Sëmundjet e EPI

2.1 Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit gusht 2021 janë raportuar 9 raste (Incidenca 031/100.000 banorë) me Tuberkuloz pulmonar. Nga ekzaminimet laboratorike 7 raste janë konfirmuar sputum pozitiv. Konfirmimi i tyre është kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Rastet janë të shpërndara në të gjithë vendin përkatësisht, 1 rast në Elbasan, 2 raste në Dibër, nga tre raste në Durrës dhe në Tiranë.

Gjatë muajit gusht 2021 janë raportuar 5 raste me Tuberkuloz ekstrapulmonar, përkatësisht 4 në Tiranë dhe 1 në Dibër. Nga ekzaminimet laboratorike 4 raste janë konfirmuar sputum pozitiv Konfirmimi është kryer në Laboratorin e Referencës, Tiranë. Për rastin pozitiv është lajmëruar dispanseria përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pacienti ka filluar mjekimin sipas skemës përkatëse.

3. Zoonozat

Gjatë muajit gusht 2021 me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh janë raportuar 4 raste me Brucelozë (incidena 0.14/100.000 banorë), 3 nga NJVKSH Librazhd dhe 1 nga NJVKSH Lushnjë. U krye komunikimi me strukturat veterinare dhe shërbimin epidemiologjik për ndjekjen e rasteve në vatër.

**Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike në gusht 2021
(Incidenca raste/100.000 banorë)**

	Raste, gusht 2021	Incidenca gusht 2021 (raste/100.000 banorë)
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	4	0.14
Leptospirozë	0	0
Leishmaniaza viscerale	0	0
Leishmaniaza kutane	0	0

4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit gusht 2021 janë raportuar në total 23 raste me hepatit viral (Incidenca 0.8 /100.000 banorë) nga të cilat, 19 me Hepatiti Viral A te raportuar nga NJVKSH Tiranë 18 raste dhe 1 rast nga NJVKSH Kuçovë. Me hepatit viral as A as B janë raportuar 4 raste të konfirmuara nga NJVKSH Tiranë.

5. HIV/AIDS

Në muajin gusht 2021 janë kryer në total 23 ekzaminime për HIV në Njësinë e Laboratorëve në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP). Nga këto ekzaminime 10 prej tyre kanë rezultuar pozitive (9 meshkuj dhe 1 femër). Rastet pozitive i përkasin moshave të ndryshme, një fëmijë 6 muajsh dhe përkthësisht grup-moshave 28 deri 83 vjeç. Rastet pozitive janë nga rrethet Tiranë, Elbasan dhe Kamëz. Mostrat e gjakut që kanë rezultuar pozitive kanë

ardhur në ISHP nga QSUT (Spitali Infektiv), QKTGJ, vullnetarë, laborator privat (GENIUS) dhe shoqata të ndryshme.

INSTITUTI I
SHËNDETIT PUBLIK
DEKSI